



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 64

Prishtinë, më 11 maj 2010, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Teuta Hadri dhe Vezira Emrush.

Munguan: Qamile Morina dhe Flora Brovina.

Të pranishëm: Nora Sahatqiu – UNDP, Shpresa Haxhijaj - administratore nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit dhe Liridon Selmani – KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 20. 04. 2010,**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Produktet dhe Pajisjet Medicinale,**
- 4. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për grevat,**
- 5. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 20. 04. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Produktet dhe Pajisjet Medicinale

Sadik Idriz – Për këtë pikë na informon Rita Hajzeraj, udhëheqëse e grupit punues, se deri ku ka arritur ta amendamentojë ligjin që është në procedurë.

Rita Hajzeraj – Grupi punues ka mbajtur edhe një takim të përbashkët me përfaqësues të Ministrisë, përfaqësues të AKPM - së dhe me ekspertin e angazhuar për këtë projektligj. Grupi punues ka planifikuar ta mbajë edhe një takim javën e ardhshme, për ta përmbyllur punën rreth propozimit të amendamenteve. Fokusimi i grupit punues ka qenë në tri pika më kryesore. Në mbledhjen e radhës së Komisionit do të shkojmë nen për nen. Mbledhja e grupit punues do të jetë javën që vjen, ndërsa ne presim edhe propozimet e anëtarëve të tjerë të Komisionit.

Gjylnaze Sylja – Takimi i fundit me AKPM – në ka qenë një takim i rëndësishëm dhe kemi marrë informata shumë të rëndësishme sa i përket autoriteteve kompetente dhe komisioneve vlerësuese. Grupi punues do ta vazhdojë punën dhe presim propozime dhe amendamente edhe nga anëtarët e tjerë të Komisionit.

Teuta Hadri – Në takimin e fundit diskutuam shumë për anëtarët e Komisionit Këshillëdhënës, kush do të jenë anëtarët e këtij komisioni dhe për kompetencat e tyre. A ka arritur grupi punues të marrë ndonjë qëndrim lidhur me këtë pikë?

Rita Hajzeraj – Kemi pasur disa diskutime me AKPM - në, dhe në mbledhjen e radhës së grupit punues do të definohen edhe anëtarët e këtij komisioni këshillëdhënës.

Nurishahe Hulaj – Pyeti: a kanë laborator galenik barnatoret në Kosovë?

Rita Hajzeraj – Tha se në ligj kërkohet që çdo barnatore të ketë laborator galenik, por nuk mendoj se duhet që çdo barnatore patjetër ta ketë këtë laborator.

Sadik Idriz - Propozoi të pritet përfundimi i punës në grup punues, pastaj edhe Komisioni ta përfundojë punën sa më shpejt, sepse është një ligj mjaft i rëndësishëm.

4. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për grevat

Sadik Idriz – Ky Projektligj ka kaluar në lexim të parë në Kuvend. Projektligji para miratimit në parim nuk ka marrë përkrahjen e Komisionit. Mirëpo Projektligji është miratuar në parim nga Kuvendi. Edhe ligji i punës ka arritur në Kuvend, prandaj nuk ka asnjë pengesë për amendamentim të Projektligjit të grevave.

Pas diskutimeve Komisioni formoi grupin punues në përbërje:

Teuta Hadri – kryesuese,
Vezira Emrush –anëtare,
Nurishahe Hulaj – anëtare.

5. Të ndryshme

Sadik Idriz – Lidhur me këtë pikë tha se kemi një informatë nga zyrtarja e UNDP - së, Nora Sahatqiu, lidhur me Draftdokumentin për gjendjen në shëndetësi.

Nora Sahatqiu – Tha se sipas diskutimeve që kemi pasur në mbledhjen e kaluar, lidhur me dokumentin të cilin e kemi filluar, propozimet tuaja janë përfshirë në draftin e dytë dhe drafti do të ju dërgohet për shqyrtim. Nëse pajtoheni, sipas propozimit tuaj, ky dokument të jetë një deklaratë e Komisionit për fuqizimin e punës së Komisionit dhe fuqizim e rolit të tij në përmirësimin e gjendjes në shëndetësi. Propozimi është që takimi i radhës për shqyrtimin e këtij dokumenti të jetë më 21 maj. Propozojmë që në atë takim të jenë të përfshirë më shumë njerëz, si përfaqësues të shoqërisë civile që punojnë në shëndetësi, Komisioni, si dhe disa përfaqësues të organizatave të huaja që punojnë me shëndetësinë.

Diskutimet dhe propozimet nga takimi i kaluar janë përfshirë në Draftdokument dhe kanë dalë edhe disa rekomandime.

Teuta Hadri – Tha se qëllimi i Komisionit është që ligjet të kenë mundësi të zbatohen. Propozimi është që të krijohet një zyre ndërlidhëse në mes të Komisionit dhe Ministrisë së Shëndetësisë, në mënyrë që ligjet të jenë sa më të zbatueshme. Nga ai draft i propozuar krijohej një përshtypje që asgjë nuk është punuar nga Komisioni deri me tani, në të vërtetë Komisioni ka punuar në tri mandate, por ka nevojë për avancim më të madh sa i përket zbatimit të ligjeve.

Gjylnaze Syla – Tha se dokumenti duhet të jetë një deklaratë e Komisionit, dhe një qëndrim i Komisionit për riafirmimin e shëndetësisë dhe punës së Komisionit, si dhe një kërkesë që shëndetësia duhet të jetë prioritet për të gjithë.

Çështje tjetër që duhet diskutuar është edhe vendimi për dokumentin e Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian. Komisioni duhet ta ftojë ministrin dhe të diskutohet përmbushja e pikave që parashihen në këtë plan të veprimit nga fushëveprimtaria e Komisionit.

Sadik Idriz – Pikat e parapara në planin e veprimit, janë pika që duhet të përmbushen nga ministritë përkatëse. Komisioni, në të ardhmen, do ta ketë në agjendë diskutimin rreth këtyre pikave që janë në fushëveprimtarin e Komisionit tonë dhe të shikojmë edhe mënyrën dhe mundësinë e përmbushjes.

Gjylnaze Syla – Të kërkojmë nga ministria përkatëse informatë se çfarë kanë punuar në arritjen e përmbushjes së këtyre pikave.

Sadik Idriz – Propozoj që në mbledhjen e radhës të diskutohet rreth kësaj pike, se çfarë është përmbushur dhe çfarë informatash duhet të kërkojnë nga ministria për përmbushjen e këtyre pikave të parapara në Planin e Veprimit.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz